

Landi rekomandon dënime më të ashpra

Mbeturinat e egra kushtojnë shumë para



Mbeturina plastike notojnë në Aasee: Landi i NRW ju sygjeron qyteteve gjoba më të larta për ndotjen e ambjentit.

Foto Mathias Ahlke

Nga Dirk Anger

Sa mund të kushtojë hedhja e bishtave të cigareve

Münster. Nuk duhet bërë njësoj si në Singapur. Atje u dënua padrejtësisht një burrë me një gjobë prej 195 Euro, sepse hodhi dy rripa gome në rrugë. Por në landin e Vestfalisë-Veriore tani mund të kushtojë më shtrenjtë një bisht cigareje apo paketë e hedhur në rrugë, si edhe një hedhje në gjelbrim e gotës së kafes to-go. Këto kundravajtje administrative nuk do të dënohen më me 25 si deri tani, por me 100 Euro.

Rregullat e reja për gjobat ju japin autoriteteve një mbështetje të vendimeve për mbrojtjen e mjedisit. Gjobat arrijnë në 100 Euro për hedhjen e paligjshme të mbeturina/paketave të vogla (shtëpiake), sendeve si p.sh. bishtat e cigareve, gotat e kafes një përdorimshe, pjatat prej letre, mbetjet e frutave dhe të ushqimeve për pajisjet e

kuzhinës, kutitë e pijeve deri në 50 000 Euro edhe më shumë për hedhjen rregullisht me sasi të mëdha të lëndëve të rrezikshme për mjedisin si vaji i vjetër, bojat/ngjyrosjet ose mbetjet nga ndërtimet. Për hedhjen e bishtave të cigareve ose të çamçakizit sipas administratës në Münster mund të shkoj 50 Euro, gjithashtu edhe për hedhjen e shisheve dhe të kutive të

konservave. Pllakatat ose letrat ngjitëse në koshat e plerave etj. kushtojnë 150 Euro, në monumente kulture ose strehat e autobusave deri në 200 Euro. Megjithatë bëhet fjalë vetëm për një vendim sipas rastit e në bazë të rrethanave, sqaroi zëdhënësi i qytetit.

-pd/da-

Detyrë:



1. Shiko gjithashtu edhe fotografinë dhe përshkruaj çfarë është paraqitur në të.

Fjalët/thëniet e mëposhtme të ndihmojnë:

Në këtë fotografi unë shikoj

Së pari/përpara gjenden

Në liqen notojnë

Mbrapa/pas /në sfond

2. Lexo titullin. Për çfarë mund të bëhët fjalë në tekst.

Bëj kryq:

<input type="checkbox"/>	Mjelma të egra në qytet	<input type="checkbox"/>	Tarifat e mbeturinave në Land
<input type="checkbox"/>	Kostot për shishet plastike	<input type="checkbox"/>	Para për thesat e verdhë
<input type="checkbox"/>	Gjopa për hedhjen e mbeturinave	<input type="checkbox"/>	Ndotja e ambientit

3. Lexo artikullin e gazetës në grupe të vogla dhe përgjigju pyetjeve të mëposhtme.

3.1 Bëj kryqin në përgjigjen e saktë.

a) Përse duhet të paguante një burrë në Singapur 195 Euro gjobë?

<input type="checkbox"/> Ai po pinte një kafe në rrugë	<input type="checkbox"/> Ai hodhi në rrugë dy rripa gome
<input type="checkbox"/> Ai hodhi një copë çamçakizin	<input type="checkbox"/> Ai po ngiste makinën shpejt

b) Për çfarë po planifikon landi i Vestfalisë-Veriore rritjen e gjobës në 100 Euro?

<input type="checkbox"/> Për hedhjen e shisheve plastike nëpër ujëra	<input type="checkbox"/> Për hedhjen e vajrave të vjetra dhe bojrave
<input type="checkbox"/> Për hedhjen e paketave të qytetarëve dhe të gotave të kafes to-go	<input type="checkbox"/> Për hedhjen e mbetjeve ndërtimore në pyll

c) Sa është gjopa në Münster për hedhjen në rrugë të shisheve dhe kutive të kosnervave?

<input type="checkbox"/> 50 Euro	<input type="checkbox"/> 100 Euro
<input type="checkbox"/> 150 Euro	<input type="checkbox"/> 5000 Euro



3.2 Formulo një fjali të re

Nganjëherë artikujt e gazetave kanë fjali të gjata. Për shembull:

„Gjobat arrijnë në 100 Euro për hedhjen e paligjshme të mbeturina të vogla (shtëpiake) sendeve si p.sh. bishtat e cigareve, gotat një përdorimshe të kafes, pjatat prej letre, mbetjet e frutave dhe të ushqimeve nëpër pajisjet e kuzhinës ose kutitë e pijeve dhe deri në 50 000 Euro edhe më shumë për hedhjen rregullisht me sasi të medha të lëndëve të rrezikshme për mjedisin, si vaji i vjetër, bojrat/ngjyrosjet ose mbetjet materialeve të ndërtimeve.“

Fjalja mund të kuptohet më mirë në qoftë se bëhen disa fjali prej saj.

Bëj një formulim të ri:

Ka gjoba në shuma të ndryshme. 100 Euro duhet të _____

_____ kutitë e pijeve.

Shtrenjtë është edhe _____

_____.

Deri në 50 000 Euro do të kushtojë _____

_____.

3.3 Plotëso fjalën që mungon.

a) Përse një burrë në Singapur duhej të paguante 195 Euro gjobë?

_____.

b) Landi i Vestfalisë-Veriore po planifikon një ngritje të gjobave nga 25 në _____ Euro për bishtat e cigareve _____ dhe _____.

c) Lejohet hedhja e çamçakizave në qytetin e Münsterit? _____.

d) Çfarë është në Münster me gjobën për hedhjen e shisheve dhe kutive të konservave?

e) Sa e lartë është gjoba e re për hedhjen rregullisht të mbetjeve të ndërtimit dhe vajit të vjetër?



4. Kush është mendimi juaj?

a) Përse ka në Landin tonë gjoba? Argumentojeni këtë me disa fjali.

b) Ju duken në rregull ju gjoba të tilla? Argumentoje përgjigjen!

c) Njihni ju në lagjen e qytetit tuaj vende, ndërtesa apo sheshe që shpesh janë të ndotura? Cilat?
